



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 297/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, rr.“Armend Daci” nr. 1 Prishtinë, kundër debitorit N.T.P “V.Ç. ” me pronar B.Ç. , me numër të biznesit ....., me adresë Fshati ....., Kaçanik, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1/2019, të datës 08.01.2019, të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 30.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit N.T.P “V.Ç. ” , i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.1/2019, të datës 08.01.2019, të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli.
- II. MBETET NË FUQI urdhri përmbartimor P.nr.1/2019, i datës 08.01.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh B. Tasholli.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Bardh B. Tasholli, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me datë 08.01.2019, ka lëshur urdhrin përmbartimor P.nr.1/2019, me të cilin ka lejuar prapësimin në bazë të dokumentit përmbartimor Aktvendimit të Komisionit i Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.5040, të datës 07.11.2016, me të cilën është urdhëruar debitori që t’ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 5,000.00 € si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me tarifatat në fuqi, me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogaritë e kreditorit, si dhe regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen publike të sendeve të

luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e këtyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit si dhe të paguhen shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me tarifat në fuqi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se dokumenti përbarues në bazë të cilit është iniciuar procedura përbarimore nuk e ka klauzolën e përbarueshmërisë dhe se në mungesë të këtyre të dhënave, gjykata duhet të shfuqizoj urdhrin për përbarim, ndërsa propozimin për përbarim ta refuzoj si të pa bazuar. Po ashtu ka shtuar se duke u bazuar nën nenin 360 par 1 të LMD –së, kërkesa është parashkruar, andaj i ka propozuar gjykatës që ta shfuqizoj urdhrin për përbarim, ndërsa propozimin për përbarim ta hedh poshtë si të palejuar, ose ta refuzoj si të pa themeltë si dhe për këtë çështje përbarimore të hap seancë për të sqaruar problemin në themelet e saj.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit në prapësim, pasi që me asnjë veprim juridik dokumenti në bazë të së cilit është iniciuar propozimi për përbarim nuk është anuluar, prish ose ndryshuar, gjegjësisht nuk e ka humbur efektin juridik. Ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet se vendimi nuk e ka klauzolën e përbarueshmërisë dhe ekzekutueshmërisë dhe nuk është në origjinal, pasi që kreditori propozimit i ka bashkëngjitur dokumentin në kopje të vërtetuar ndërsa vulën e përbarueshmërisë në këtë rast e ka dhënë organi shtetëror i KPMM –së. Pretendimet e debitorit rreth parashkrimit të kërkesës i ka kundërshtuar duke u bazuar në nenin 361 të LMD- së. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri i përbaruesit privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të*

*dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin Nr.5040, të datës 07.11.2016, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Vendimi Nr.5040, i datës 07.11.2016, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr.5040, i datës 07.11.2016, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, original apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi Nr.5040, i datës 07.11.2016, i nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, është bërë i formës së prerë me datë 14.12.2018 dhe i ekzekutueshëm nga data 30.12.2018.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.297/22, datë 30.09.2022

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.